



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN

Nr. 1870₁₂ / prot.

Paskuqan, më ____ . ____ .2025

RELACION

“Mbi emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz”

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për detyrat tuaja funksionale që realizoni pranë Këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi ndryshimin e emërimit të rrugëve në Njësinë Administrative Paskuqan, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 9270, date 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”; Vendimit nr. 226 prot., date 27.03.2023 “Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz”; si dhe referuar kërkesës me shkrim të banorëve të rrugës “Ejup Topojani”, të depozituar pranë Njësisë Administrative Paskuqan për emërtim rruge të lagjes së tyre.

Në bazë të verifikimeve në terren nga grupi i punës rezulton që firmat korrespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe ju propozojme ju në cilësinë e organit legjislativ të Bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për ndryshimin e emërimit të rrugës të cituar si më poshtë:

- Aktualisht: Rruga “Ejup Topojani” propozohet të ndryshohet në Rruga “Fadil Destan Kordhaku”.

Z. Fadil Destan Kordhaku është dalluar si ushtar shembullor në marrëdhënie me shokët dhe gjatë kryerjes së detyrës ku në krye të saj, në punimet xhenjiere bie në krye të detyrës më 19.08.1970 duke lënë në pikëllim familjen e të afërmit të tij kurrë të harruar, familje si dje dhe sot e nderuar dhe e respektuar. Me mirënjohjen më të madhe për z. Fadil, banorët kërkojnë nga Bashkia Kamëz që në nder të tij të vendoset emri i tij në këtë rrugë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesat me shkrim për ndryshimin e emërimit të rrugëve dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qëllim realizimin e kërkesës së qytetarëve.

Për sa më lartë:

PROPOZOJMË

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për ndryshimin e emërimit të rrugëve, me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korenspondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

Komisioni i posaçëm:

- Zaim Dedaj

Firma:

ADMINISTRATOR
Eduart BODINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN


Nr. 1870 prot.

Paskuqan, më 20.08.2025

Lënda: Kërkesë për ndryshim emërtimi rruge

KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ
Z. Hysen KOLDASHI

Adresa: Bulevardi 1 "Nënë Tereza" Nr. 492 Kamëz



Duke shprehur konsiderata mbi veprimtarinë tuaj, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9270, date 29.07.2004 "Për sistemin e adresave"; Vendimit nr. 226 prot., date 27.03.2023 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz"; si dhe referuar kërkesës me shkrim të banorëve të rrugës "Ejup Topojani", të depozituar pranë Njesisë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz me nr. 1870 prot, date 18.08.2025.

Kërkojmë nga ana juaj në cilësinë e organit përfaqësues të Bashkisë Kamëz, marrjen në shqyrtim të kërkesës së parashtruar nga komuniteti i kësaj lagjeje për ndryshimin e emërimit të rrugës së lagjes së tyre nga rruga "Ejup Topojani" në rrugën "Fadil Destan Kordhaku". Banorët shprehen se z. Fadil Destan Kordhaku është dalluar si ushtar shembullor në marrëdhënie me shokët dhe gjatë kryerjes së detyrës ku në krye të saj, në punimet xhenjiere bie në krye të detyrës më 19.08.1970 duke lënë në pikëllim familjen e të afërmit të tij kurrë të harruar, familje si dje dhe sot e nderuar dhe e respektuar. Me mirënjohjen më të madhe për z. Fadil, banorët kërkojnë nga Bashkia Kamëz që në nder të tij të vendoset emri i tij në këtë rrugë.

Bashkëlidhur:

- Kërkesa me nr. 1870 prot, date 18.08.2025.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

ADMINISTRATOR
Eduart BODINI



NJESIA PASKUQAN

PROTOKOLLI

NR 1870 DT 18-08-2025

Datë 13/08/2025

Kërkesë për ndryshim emërtimi rruge

Drejtuar:

Z.Hysen Koldashi

Këshillit Bashkiak Kamëz

Z.Rakip Suli

Kryetar, Bashkia Kamëz

Z.Eduart Bodini

Njësia Administrative Paskuqan

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për punën tuaj , kerkojmë nga ana juaj ndryshimin e emërtimit te rrugës

“Ejup Topojani” në “Fadil Dostan Koradhku”

Bashkëlidhur do të gjeni :

- Biografinë për Fadil Dostan Kordhaku
- Firmat e banorëve të kësaj rruge
- Planvendosja e rrugës që kerkojmë ndryshim emërtimi rruge

Faleminderit paraprakisht !

Firmat e banorëve të rrugës:

[illegible]

